

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N.N. “L.N” në Prishtinë, të cilin e përfaqëson B.L, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - DUKMM në Prishtinë, për dëmshpërblim, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.24/2013, datë 17.04.2015, në seancën e mbajtur më 2.2.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit N.N. “L.N” në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.24/2013, datë 17.4.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.24/2013, datë 17.4.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit N.N. “L.N.” në Prishtinë dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.260/2012, datë 08.10.2012, me të cilin është refuzuar se e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që, në emër të dëmshpërblimit për atë që ka investuar në infrastrukturë, t’ia paguajë atij shumën prej 138.469,22 € dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe çështja t’i kthehet për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se objekt i kërkesëpadisë së paditësit është dëmshpërblimi në shumë prej 153.024,48 €, të cilën shumë ai e kishte investuar sipas aktvendimeve të posaçme për rregullimin e infrastrukturës në kompleksin banesor që ndodhet në lagjen “...” në Prishtinë, kompleks këtë që e kishte ndërtuar pasi që paraprakisht kishte siguruar lejen nga e paditura, në fillim për ndërtimin e kompleksit afarist dhe pastaj, pa miratimin e të

paditurës, objektin afarist e kishte shndërruar në kompleks banesor. Pas përfundimit të kompleksit banesor, paditësi kishte kërkuar disa herë me shkresë nga e paditura rregullimin e infrastrukturës, por ajo nuk i është përgjigjur pozitivisht kërkesës, prandaj paditësi e kishte rregulluar infrastrukturën me shpenzime vetjake.

Sipas pretendimeve të paditësit, qëndron detyrimi i të paditurës që t’ia paguajë shumën e kërkuar në emër të kompensimit të dëmit, duke pasur parasysh se e paditura nuk i ka përmbushur obligimet për ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse, për të cilat i ka lëshuar lejet e ndërtimit.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, ka gjetur se nuk qëndron detyrimi i të paditurës që paditësit t’ia kompensojë të hollat që ajo i ka investuar në infrastrukturë, pasi që ajo nuk kishte marrë si obligim kontraktues investime konkrete. Këto investime bëhen në bazë të programeve prioritare të komunës, kështu që, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit nuk i takon e drejta për të kërkuar pagesën e investimeve, pasi që këto ishin bërë pa lejen e të paditurës, duke bërë edhe ndryshimin e destinimit nga objekti afarist në objekt banimi, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimimit, e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë, në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të tilla që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij për sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ashtu si të dy shkallët e gjykatave, edhe kjo Gjykatë mendon se, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, nuk është shkelur ligji në dëm të tij, për faktin se palët ndërgjyqëse nuk kishin lidhur marrëveshje për ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse të objekteve, të cilat i ka ndërtuar ai. E paditura, me rastin e lëshimit të lejes për ndërtimin e objekteve të paditësit, sipas aktvendimeve që gjenden në shkresat e lëndës, nuk ka parashikuar afatin për ndërtimin e infrastrukturës. Realizimi dhe rregullimi i hapësirës së përfshirë brenda lagjes “Kalabria” në Prishtinë është përcaktuar me vendimin e miratuar nga e paditura, 01.Nr.35-18196, datë 3.8.2005, sipas të cilit ndërtimi i destinimit hapësinor është përcaktuar të bëhet sipas procedurave të parashikuara për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullativ “...”. Këto investime paditësi i ka bërë për interesat e veta personale, duke ndërruar pa pëlqimin e të paditurës destinimin e objektit. Për këto arsye, kjo Gjykatë përfundon se gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur ka konstatuar se paditësi nuk ka provuar që për fajin e të paditurës t’i jetë shkaktuar dëmi dhe, për këtë arsye, nuk qëndron detyrimi i saj që t’ia kompensojë dëmin në kuptim të dispozitës së neneve 154 e 158 të LMD. Ndërkaq, për arsyet që kanë dhënë gjykatat e instancave më të ulëta,

sikurse edhe për arsyet e parashtruara nga kjo Gjykatë, të dy aktgjykimet, nga aspekti i zbatimit të së drejtës materiale, cilësohen të ligjshme.

Kjo Gjykatë i vlerësoi parashtrimet në revizion se gjykata e shkallës së dytë nuk i ka vlerësuar pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga dispozita e nenit 182.1 të LPK, lidhur me dispozitën e nenit 153.1 të LPK, (aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është marrë në afatin e parashikuar ligjor), por gjeti se shkeljet e tilla nuk përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes nga ajo që kanë vendosur të dy gjykatat.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilave u referohet revizioni, ngase dispozitivi i aktgjykimit të saj është i qartë dhe jo në kundërtënie me arsyetimin. Arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante, të vlefshme për një gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike.

Parashtrimet në revizion lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme, për faktin se ato nuk janë saktësuar dhe arsyetuar në kuptim të ligjit, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur brenda kufijve dhe shkaqeve të vëna në dukje në revizion (neni 215 i LPK-së).

Parashtrimet në revizion se obligimi i të paditurës për ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse të objektit, që është realizuar nga paditësi, rrjedh nga kompetencat e saj të përcaktuara me dispozitën e nenit 15 par. 1 (f) të Statutit të Komunës së Prishtinës, kjo Gjykatë i vlerësoi dhe i gjeti si të papranueshme, për faktin se kjo nuk paraqet bazë të mjaftueshme për miratimin e kërkesëpadsisë së paditësit, me gjithë faktin se në Statutin e Komunës qëndron detyrimi i të paditurës që ta rregullojë infrastrukturën, duke qenë se, me rastin e lëshimit të lejeve, nuk është përcaktuar afati për ndërtimin e infrastrukturës së objekteve, të cilën paditësi e ka rregulluar vetë, pa pëlqimin e të paditurës dhe pa pritur që plani të përfundojë në bazë të Programit prioritar të komunës.

Nga sa u tha më sipër dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

E.Rev.nr.7/2016, datë 2.2.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani